



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 53/19
Prishtinë, më 29.05.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Arbërie Nagavci, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Fikrim Damka, Dardan Molliqaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontic dhe Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës tjerë: Besim Zeqiri - Këshilltar-BB/IFC, Gazmend Hoti - Ekspert i Inspektoratit-M.T.I, Durim Limaj-Shef Kabineti-M.T.I, Sanije Berisha - monitoruese- OSBG; Agnesa Haxhiu-KDI, Majlinda Jashanica-AKTIV, Marigona Berisha-Asistente-GP LDK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli, Doruntina Pireva-Praktikante, Sofie Tahiri-Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari).

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.05.2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social dhe amendamenteve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale;
4. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256;
5. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Arbërie Nagavci: Propozojë që pika e katërt e rendit të ditës apo miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të shtyhet në mbledhjen e radhës, sepse ky projektligj dhe amendamentet e komisionit nuk janë shqyrtuar në Komisionin për Legjislacion, i cili duhet vlerësojë përputhshmërinë e Projektligjit dhe të amendamenteve me Kushtetutën. Dy herë ka qenë në rendin e ditës dhe mbledhja është shtyrë për shkak të seancës. Ne si grup parlamentar i kemi dërguar një letër Kryeministrit dhe Kryeparlamentarit që të kërkojë një opinion të dytë nga Komisioni i Venedikut lidhur me këtë çështje, që për sa jam në dijeni një opinion të tillë e ka kërkuar edhe Zyra e BE-së. Poashtu kemi edhe reagimin e 100 organizatave civile në lidhje me këtë projektligj, andaj propozojë që miratimi i raportit të shtyhet të paktën në mbledhjen e radhës.

Kryetari: Si kryetar e mbështes propozimin e znj. Nagavci për shtyejen e miratimit të raportit për një mbledhje tjetër, jo për shkak të mosshqyrtimit të projektligjit nga komisioni për legjislacion, pasi që që kanë kaluar afatet procedurale, por për shkak të vërejtjeve të Zyrës së BE-së dhe OJQ-ve.

Dardan Molliqaj: Meqenëse nuk ka arsye ligjore dhe në bazë të Rregullave të Kuvendit nuk kemi nevojë ta tërheqim raportin. Besoj se para se të shkojnë në Kuvendin raportin, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit dhe forcat parlamentare kanë hapësirë për të vepruar. Në punën në grup punues, mund të konstatoj se përveç nenit mbi ndarjen e fondeve për grupet e reja parlamentare që krijohen, kemi pasur konsensus për shumicën e ndryshimeve tjera të propozuara. Konsideroj që kjo çështje mund të bëhet shumë e thjeshtë që të votojmë sot raportin dhe të procedojmë tutje dhe i ftoj për diskutime të gjithë ata që kanë shqetësime sepse argumentet i kanë të paqëndrueshme.

Kryetari konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, me 3 vota Për, 6 vota Kundër dhe Ansjë votë Abstenim, nuk miratohet propozimin e deputetes Arbërie Nagavci për shtyrjen e pikës së katërt të rendit të ditës për një mbledhje tjetër të komisionit dhe rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.05.2019

Kryetari: Kostatoi se Komisioni unanimisht miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 14.05.2019, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social dhe amendamenteve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari: Theksoi se kam kërkuar nga Ministria e Financave një vlerësim për amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, pasi që projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore, dhe më kanë njoftuar me shkrim se kostoja shtesë e amendamenteve është 42,000 euro. Mendojë që është një shumë e përballueshme për Buxhetin e Kosovës, propozojë ta përkrahim projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe të procedojmë tutje.

Arbërie Nagavci: Mënyra se si është amendamentuar projektligji ka bërë që Këshilli Ekonomiko-Social të mbetet si organ këshillëdhënës dhe meqë nuk ka të drejtë vendimmarrje, si e tillë nuk sjell asgjë të mirë në përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

Enver Hoti: Këshilli duhet të rrisë funksionalitetin në aspektin ekonomik-social, ndërsa nevojat për një debat social janë më të mëdha. Puna që është kryer në grupin punues dhe në Komisionin për shëndetësi mundëson një funksionalizëm më të mirë të këtij Këshilli dhe mendojë se duhet përkrahur këtë Projektligj.

Pas përfundimit të diskutimeve, në bazë të propozimit dhe rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota Për, 2 vota Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr.06/L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko–Social, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për Projektligjin nr.06/L-131 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko–Social, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 8, për të cilin Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerësojë se përmban kosto që është përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- 4. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256**

Kryetari: Theksoi se kam kërkuar interpretim prej Zyrës Ligjore të Kuvendit sa a duhet të votojmë raportin dy herë, të cilin e kemi votuar njëherë dhe e kemi proceduar në komisionet tjera të përhershme. Më duket absurde si procedurë dhe si praktikë. Nëse nuk ka komente apo vërejtje nga komisionet e përhershme pse duhet edhe njëherë të votohet në komision. Zyra Ligjore me kanë thënë në bazë të Rregullores së Kuvendit raporti final duhet votuar nga komisioni funksional para se të procedohet në Kuvendit për shqyrtim. Këtë çështje duhet rregulluar me Rregulloren e Re.

Safete Hadergjonaj: Lidhur me çështjen e votimit të raporteve finale për projektligje, kemi pasur diskutimeve edhe në kaluarën dhe administrata e Kuvendit ka dhënë opinionin se raporti final duhet votuar nga komisioni funksional para se të procedohet në seancë. Por, unë mendojë që kur raporti nuk ka vërejtje prej komisioneve tjera të përhershme nuk kemi çfarë e qesim për votim në komision. Nëse ka vërejtje prej komisioneve tjera duhet shqyrtuar edhe njëherë në komision. Përndryshe raporti duhet proceduar direkt për seancë.

Naser Osmani: Mendojë se ne nuk duhet votuar diçka që kemi votuar me herët nëse komisionet tjera të përhershme nuk kanë vërejtje. Ishte dashur që raporti të procedohet përmes Kryesisë në Kuvend. Theksoi se për shumicën e çështjeve si grup punues kemi pasur konsensus në amendamentet e propozuara. Shoqëria Civile jep mendime, ndodhë që të kontribuojnë në vendimmarrje të drejtë, ndërsa shtetin e bëjnë ata që kanë përgjegjësi kushtetuese e që janë deputetët. Siç e dijmë propozues i Projektligjit është Zyra e Kryeministrit, të cilët nuk kanë ardhur në grup punues për ta prezantuar dhe arsyetuar draftin. Draftligji nuk ka qenë mirë i hartuar, prandaj i kemi propozuar ndryshimet. Nuk ka pasur fare limit në dhënien e kontributeve. Ne kemi rikthyer siç ka qenë në ligjin bazik, me përjashtim që në kohën e zgjedhjeve me pas një dyfishim, pasi që shpenzimeve ndodhin në kohën e zgjedhjeve. Kufizimet janë paraparë edhe me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave, ku është përcaktuar limiti prej 10,000 euro.

Lidhur me zvogëlimin e shumave të gjobave prej 40,000 euro e dënimeve është bërë me qëllim të mbrojtjes së partive të vogëla. Çështja e transparencës është përmisuar krahasur me ligjin e kaluar, pasi që krijohet një ueb faqe në KQZ dhe parashihet që çdo tre muaj të publikohen raportet financiar. Poashtu raportet duhet publikuar edhe në ueb faqet e subjekteve politike. Çdo donacion mbi 500 euro shoqërohet me një deklaratë të dhënësit dhe një kupon që lëshohet nga marrësi i atyre parave dhe këto shuma raportohet në pasqyrat financiare të subjekteve politike.

Çështja e funksionimit të Zyrës për certifikimin dhe regjistrimin e subjekteve politike, kemi kërkuar të na jepet një shembull se në cilin shtet të BE-së apo të shteteve të Evropës, e ka të rregulluar çështjen e zyrës si të pavarur ashtu siç është propozuar me projektligj dhe nuk kemi marrë shembuj apo praktika të tilla. Duke pasur parasysh faktin se sistemi ynë kushtetues nuk lejon ekzistimin e institucioneve të pavarura brenda institucionit të pavarur, ne vetëm e kemi larguar që vendimet përfundimtare për çështjet e parapra me këtë projektligj nuk i nënshkruan drejtori i zyrës, por përfaqësuesi i KQZ-së, që propozohet nga Këshilli Gjyqësor dhe emërohet nga Presidenti i shtetit dhe kemi të bëjmë me një pozicion apolitik. Ndërsa, ne i kemi lënë Zyrës buxhet dhe staf profesional prej dhjetë personash. Sa i përket Komisionit Venedikut kemi sqaruar se ky komision jep rekomandime dhe nuk merret me hartimin e ligjeve detale dhe vlerësime parimore se a është në kuadër të sistemit demokratik dhe të sigurimit të transparencës. Me amendamentet e propozuara ne kemi rregulluar edhe çështjen e të drejtës së ankesës të dyshkallshmërisë.

Dardan Molliqaj: Sa i përket kufizimit të dhënies së donacioneve me akuzu komisionin tonë që nuk e kanë rregulluar këtë çështje është hipokrizi. Siç tha z.Osmani ne e kemi rregulluar këtë çështje me amendamente. Siç ka qenë propozimi me Projektligj që ka qenë edhe në Komision të Venecias, në Kosovë ke mundur të japësh para sa të duash apo deri 1 milion euro. Ne e kemi kufizuar shumë dhe e kemi rritur vetëm për fushatë dhe maksimumi që mund një person mund të jap për biznes është 20,000 euro dhe një individ 10,000 euro. Sa i përket keshit, nuk ka dallim a merr para kesh apo transfer bankar, çështja është se a i deklaron paratë e marra apo jo? Subjekti politik raporton për donacionet e marra sikurse që bëhet deklarimi në bank. Nuk është çështja tek të hyra, sa është puna të shpenzimet që duhet të bëhen sa ma shumë në mënyrë bankare.

Dënimet nuk janë problem vetëm për partitë e vogla, por për edhe partitë e mëdha sepse për të gjitha shkeljet në fushatë mund të aplikohet një dënim prej 40,000 euro dhe dënimi mund të jetë edhe për postera. Krahasur me rajonin ne kemi zgjidhjet më të mira, si për nga pranueshmëria, korrektesia dhe zgjedhjet në fushatë. Nuk është vetëm për partitë e vogëla, por edhe për partitë që nuk kalojnë pragun e zgjedhjeve, obligimet i marrin për shkeljet eventuale, por jo edhe përfitimet, pasi që fondi për demokratizimin e partive politike shpërndahet vetëm për partitë që kalojnë pragun zgjedhor. Sa i përket kompetencave të Zyrës në KQZ, as Zyra e BE-së, as me projektligji nuk kanë dhënë argumente pse na duhet kjo zyrë. Përkundrazi ne kemi dhënë argumente se kjo e prish hirearkinë kushtetuese. Unë besojë se duhet me votue sot raportin dhe ne si komision duhet të jemi të hapur për çdo debati pasi që me këtë ligj dhe me ndryshimet e propozuara e rregullon më mirë këtë fushë.

Arbërie Nagavci: U fol për konsensusin e përgjithshëm dhe konstruktivitetin, duke qenë që unë kam qenë pjesë e grupit punues, sigurisht që diskutimi ka qenë konstruktiv dhe me argumente, por nuk është se ka pasur konsensus të plotë për secilën çështje. Personalisht së bashku me deputeten Haxhiu i kemi paraqitur 8 amendamente që nuk janë përfillur dhe që nënkupton se propozimet kanë qenë kundër asaj që ne kemi paraqitur. Mundem me përmend që takimet kanë qenë të mbyllura dhe unë kam kërkuar të jenë të hapura, madje këtë kërkesë e kam paraqitur edhe tek kryetari. Argumeti ka qenë se i kemi dëgjuar grupet e interesit për këtë çështje dhe nuk ka nevojë që ti thërrasim prapë. Edhe pse është legjitime që nëse paraqiten argumente të reja me pas qëndrime tjera dhe duhet me qenë korrekt edhe kolegët që nuk ka pasur konsensus për të gjitha çështjet.

Naser Osmani: Përafësisht kemi pasur qëndrime unike. Ne kemi 73 amendamente, nëse kemi pajtueshmëri për 65 prej tyre atëherë nuk mund të themi se nuk ka pasur konsensus për shumicën prej

tyre. Ne kemi takuar përfaqësuesit e shoqërisë civile, të Zyrës BE-së, OSBE-së dhe përfaqësuesit e subjekteve politike parlamentare. Amundamentimi është çështje e deputetëve, nuk ka të drejtë askush tjetër të ndërhyjë.

Ali Lajçi: Jeta jonë institucionale ka nevojë më shumë për këshillim dhe në kuptim të funksionimit kemi ligje të mira që nuk zbatohen. Kemi benefite tjera që kanë partitë, grupet e reja parlamentare në rast kjo do kishte synim realizimin e qëllimeve të mira, atëherë është ngatërruar, çështja kur është menduar se kemi prekur punën e KQZ-së ku zakonisht partitë politike të cilat garojnë janë dhe përfituese në buxhetin që ndahet. Por siç ka mbetur që grupet e reja parlamentare që të përfitojnë buxhet, kjo është bërë sigurisht për interesa të PSD-së. Por, pastaj buxheti që është çështje që mund të shtrohet por faktikisht me rregullime të përparshme jep interes të ri. Qëllimet janë shpesh të mira e shpesh ngatërruese, këtu qëndron problemi.

Dardan Molliqaj: Dy çështje: e para administrata e komisionit gjitha propozimet që kanë ardhur nga institucione të ndryshme i ka përfshirë në tekstin për shqyrtim në grup punues. Nëse me këtë projektligj pretendoni se është bërë shkelje Kushtetutës dhe ligjeve dërgoni në Gjykatë, dhe nëse do keni të drejtë do fitoni. Nëse nuk vërtetohet se nuk është shkelje kushtetutese, mos folni pa argumente se nuk është e drejtë.

Ali Lajçi: Lidhur me Ligjin për Menaxhimin e Auditimit të Përgjithshëm ka kaluar çështja nga Qeveria në vend se të kalojë nga Kuvendi ose Ligji për pagat e shërbimeve publike nuk dihet a është kushtetuese a jo dhe paraqet problem për shumë çështje tjera integruese. Edhe ky ligj do të duhej verifikohet ligjshmëria e saj përmes Gjykatës Kushtetutese.

Safete Hadergjonaj: Sa i përket mbledhjeve të mbyllura apo transparencës së punës në komisione, ne kemi vizituar Komisionet për Buxhet në vende të Evropës dhe kemi parë se mbledhjet e komisioneve kanë qenë të mbyllura, mirëpo këtu tek ne kemi praktikuar që mbledhjet e komisioneve parlamentare të janë të hapura.

Unë diskutimet dhe komentet në lidhje me këtë projektligj dhe amendamentet të cilat i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa, më shumë i kam parë si keqkuptime sesa që kanë pasur të bëjnë me realitetin. Mendoj se ne si Komision në përgjithësi kemi bërë një punë të mirë dhe unë nuk pajtohem që të bëjmë institucione që nuk i ka asnjë vend i BE-së. Nuk pajtohem që të miratojmë një ligji, qoftë edhe ky ligj për financimin e subjekteve politike, i cili bie në kontradiktë me ligjet tjera.

Jam shumë e interesuar që të ketë sistem të mirë të raportimit dhe të transparencës të të gjitha subjekteve politike. Mirëpo unë kam interes që të ketë transparencë edhe të fondeve të OJQ-ve dhe qëllimin pse përdoren këto mjete. Nëse e orientojmë transparencën e për të gjitha institucionet për fondet që përdorin do të ishte në interes të përgjithshëm për shtetin. Do kisha dashur që këtë projektligj ta kalojmë tutje dhe mendoj që me këto ndryshime që janë bërë ne do ti fusim në sistem të mirëfilltë financat e partive politike, të cilat do të bëhen publike dhe të ketë transparencë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, 2 vota Kundër dhe Asnjë Abstenim, miratoi Raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256, dhe të njëjtin e procedoi për shqyrtim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 të Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie

Kryetari: Theksoi se ne kemi caktuar grupin punues për shqyrtimin e kërkesës në fjalë. Grupi Punues ka përfunduar punën dhe i ka paraqitur Komisionit raportin me rekomandime. Ftojë Kryesuesin e Grupit z. Lushtaku ta arsyetojë raportin.

Mërgim Lushtaku: Ne si grup punues kemi shqyrtuar kërkesën dhe kemi hartuar raportin me rekomandimet si vijon:

- Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, t'i caktohet paga në shumën prej 1,362.30 euro, bruto në muaj dhe zbatohet nga data e emërimit të tij nga Kuvendi, që është emëruar nga Kuvendi me dt. 28.02.2019 dhe nuk është paguar ende.
- Zëvendës-Drejtori i Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, t'i caktohet paga në shumën prej 1,195 euro, bruto në muaj.
- Paga e Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Propozim-vendimi, paguhet nga buxheti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Dardan Molliqaj: Meqenëse Ligji për paga është miratuar a e keni parë nivelin e pagës për këtë kategori?

Mërgim Lushtaku: Sqaroi se me rastin e bërjes së propozimeve, për bazë kemi marrë Ligjin e pagave dhe koeficientet e paraparë për këto kategori. Kjo edhe për faktin që kur të hynë ligji për paga në fuqi që mos të ketë ndryshim në paga.

Arbërie Nagavci: Përpos aspektit teknik, dua të ritheksoj faktin se ne kemi qenë kundër vendimit të funksionalizimit të Agjencisë ashtu siç është rregulluar me ligj, sepse kjo Agjenci është si rezultat i marrëveshjeve të Brukselit, pasi që ashtu siç është rregulluar çështja e kthimit të dokumentacionit dhe pronave është në interes të Serbisë dhe personave që kanë keqpërdorë me prona. Baza ligjore edhe për emërimin e Drejtorit nuk mendojmë se është e qëndrueshme dhe që duhet trajtuar.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota Për, 3 vota Kundër dhe 1 votë Abstenim, nuk ka korum për vendimarrje lidhur me raportin me rekomandime të Grupit Punues në lidhje me Kërkesën e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për caktimin e pagës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të kësaj Agjencie

Mbledhja përfundoi në orën 12:00
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku